



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.104, datë 27.06.2024

PËR

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.37 DATË 28.03.2024 PËR “FILLIMIN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR PROCEDURËN E TRANSFERIMIT NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR.13, DATË 16.02.2024 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË””

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 63 pika 2, 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenit 37, pika 5 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, nenet 9 dhe 15 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 4 të vendimit nr. 37, datë 28.03.2024, dhe caktimin me short të zonjës Ledina Riza, si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin Nr.13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Ndryshimin e pikës 6 të vendimit nr. 37, datë 28.03.2024, dhe caktimin me short të zotit Sokol Stojani, si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shpallur me vendimin Nr.13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Ndryshimin e pikës 11 të vendimit nr. 37, datë 28.03.2024, dhe caktimin me short të zonjës Ledina Riza, si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shpallur me vendimin Nr.13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Ndryshimin e pikës 12 të vendimit nr. 37, datë 28.03.2024, dhe caktimin me short të zotit Sokol Stojani, si relator për procedurën e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele për pozicionin vakant Nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, të shpallur me vendimin Nr.13, datë 16.02.2024 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

5. Relacioni i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
9. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda